



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:084188

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05566639

C.nr.404/2022

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, nëpërmjet gjyqtarit Robert Tunaj, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me sek. Juridike F. Kabashi, në çështjen juridike të paditësit: D.G, mësimdhënës në SH.M.P “Abdyl Ramaj” në Sh, K. S, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B. K nga P, kundër të paditurës K e S–D e A, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A. B, me objekt kontesti për kompensim kualifikimin nga marëdhënia e punës, gjykata me datë 12.04.2024, mori dhe shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.G, mësimdhënës në SH.M.P “Abdyl Ramaj” në Sh, K. S.
- II. DETYROHET** e paditura K e S – D e A, që për kompensimin e kualifikimit nga marëdhënia e punës prej 28.03.2019 deri me datë 31.12.2020, të paguajë shumën dhe atë:

#### **Për paditësin D.G:**

Për periudhën prej datës 28.03.2019 deri me 31.12.2020, të paguaj shumën prej 1.811,04 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (28.03.2022), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

- III. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket periudhës kohore 18.04.2017, deri 27.03.2019, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit.

**IV. OBLIGOHET** e paditura K e S, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 125 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### **Arsyetim**

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me datë 28.03.2022 ka parashtruar padi kundër K së S, D e A, me të cilën ka kërkuar kompensimin për kualifikimin nga marrëdhënia e punës.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës, me datë 01.11.2023 pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin e pagës, konform kualifikimit, pasi që në rastin konkret paditësi ka nënshkruar kontratën e punës, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese, duke përfshirë edhe pagën. Andaj, sipas tij të gjitha obligimet që dalin nga kontrata e punës, këtu e paditura i ka përmbushur, duke llogaritur edhe çështjen e gradimit. Ka theksuar se kërkesa e paditësit në rastin konkret është e pabazë, ngase nuk posedon licencë valide të mësimdhënies. Gjithashtu, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i njëjti ka theksuar se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit, është pjesërisht e bazuar.**

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

E drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t'u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në SH.M.P “Abdyl Ramaj” në Sh, K. S.

Këtë fakt, gjykata e vërtetoi përmes kontrates së punës, diplomës së studimeve, licenca e mësimdhënësit dhe lista e pagave dhe atë:

Kontrata e punës me numër protokolli 670/2023 me të cilën vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt në SH.M.P “Abdyl Ramaj” në Sh, K. S.

Diploma me numër 1294 e datës 22.08.2011, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se paditësi ka mbaruar studimet themelore dhe mori titullin profesor i kimisë.

Në bazë të licencës me numër 100011797, në emër të paditësit D.G

Në bazë të listës së pagave, nëpunësi D.G , me numër EM00011424, në të cilën evidentohet paga bazë e të njëjtit është 573.43€, si dhe vlera e kompensuar në emër të kualifikimit – fakultet është 68.58€.

Gjykata, me rastin e aprovimit të pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit dhe përcaktimit të lartësisë për kompensimin e diferencës në pagë për kualifikim, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë.*

Në vendimin e Qeverisë Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në paragrafin 4 pika 2 dhe 3, përcaktohet se *“Mësimdhënësit me Diplomë Universitare 3 dhe 4 vite fitojnë ngritje të pagës bazë për 27%.*

Gjithashtu, edhe në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën K e S.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e aprovoj në mënyrë të pjesshme kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroi të paditurën, që t’ia paguaj shumën monetare për periudhën kohore 28.03.2019 deri me 31.12.2020, të paguajë shumën prej 1.811,04€.

Kjo vlerë ka ardhur duke llogaritur në bazë të formulës: Paga bazë  $573.43 * 27\%$  e pagës bazë është 154.82€ - 68.58€ diferenca e paguar në pagë =  $86.24 * 21$  muaj, gjithsej = 1.811,04 euro.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh faktin se paditësi me rastin e parashtrimit të kërkesëpadisë, ka kërkuar t’i njihet e drejta e kompensimit në pagë bazuar në kualifikim prej datës 18.04.2017. Mirëpo, me rastin e kalkulimit të periudhës kohore të kërkuar nga datat e lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se për periudhën e lartcekur, të kërkuar si në kërkesëpadi, ka kaluar afati i parashkrimit prej momentit të parashtrimit të kërkesëpadisë (27.04.2022), pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, thuhet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para,*

*parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.*

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë për paditësin shumën prej 104 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore 21 euro, në shumën e përgjithshme të shpenzimeve gjyqësore prej 125 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.404/2022 data 12.04.2024**

**Gjyqtari  
Robert Tunaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.